

Datë, ___/___/___

MARREVESHJE/KONTRATE SHËRBIMI

..... Person Fizik regjistruar pranë QKB / ose i pa regjistruar në QKB me të dhënat (te dhënat e kompanisë ose ne te kundërt shëno emër, mbiemër, atësi, datëlindje, numër dokumenti, numër telefoni, adresë emaili)

me seli në adresën: _____, këtu e më poshtë referuar **“Pala e pare ose ofruesi i shërbimit ”**

....., i biri i, i dtl....., lindur në, dhe banues në, numër tel. këtu e më poshtë referuar **“Pala e dyte ose klienti, përfituesi i shërbimit”**

Ne vijim të komunikimeve të mëparshme, palët bien dakord këtu me poshtë me detyrimet dhe përgjegjësitë e përshkruara në këtë Marrëveshje Shërbimi.

Objekti

(Përshkruaj me detaje detyrat, orët e punës, dhe përgjegjësitë që do të kryejë ofruesi i shërbimit nëse nuk është e mundur këtu përshkruaji dhe referojuni aneksit I)

Gjate përmbushjes së Shërbimeve, do të përdorim të gjitha aftësitë dhe kujdesin e arsyeshëm, që të ofrohet një asistencë e sigurtë, efektive dhe e kujdesëshme.

Personi Kontakti

Pala e Pare cakton Z/Znj _____, (nese ka) si Koordinator që do të përgjigjet për koordinimin e aktiviteteve sipas kësaj Kontrate, për pranimin dhe miratimin e shërbimeve.

Pala e Dytë cakton Koordinatorin _____ si person që do të përgjigjet për koordinimin e aktiviteteve sipas kësaj Kontrate, për pranimin dhe miratimin e shërbimeve.

Neni 2 Tarifat/ Çmimi

Per ofrimin e shërbimeve, tarifa jone do të jete si më poshte:

1. Për pikën _ me lart tarifa do të jetë _____

Tarifat e lartpërmendura (*nuk përfshijne TVSH*), taksat apo detyrimet e tjera, si komisione bankare etj.

Pagesat do të kryhen paradhënie në Cash apo llogarinë bankare të Pales së parë, pranë bankës _____ me nr. Llogarie
cdo datë

Neni 3 **Kohezgjatja dhe Perfundimi**

Kjo Marreveshje Shërbimi do të jetë në fuqi dhe do të zbatohet duke filluar nga data e nënshkrimit të saj deri në përbushjen e Shërbimeve. Përbushja e Shërbimeve nënkupton _____.

Neni 4 **Konfidencialiteti**

Çdo informacion konfidencial që ka lidhje me Klientin, të cilat mund të jenë marrë nga pala I gjatë kohës së ofrimit të Shërbimeve, do të trajtohen si të tilla nga pala I (“Informacion Konfidencial”). Nuk bëhen pjesë në detyrimin për konfidencialitet informacioni:

- që ka për destinacion publikun e gjere;
- për të cilin pala I ka qenë në dijeni me parë ose i behet i ditur në mënyrë të ligjshme nga persona të tretë, të ndryshëm nga pala II, Klienti;
- nxjerrja e të cilit është e detyrueshme në bazë të ligjit, në bazë të vendimit, rregullores ose urdherit të leshuar nga organet publike kompetente, ose në bazë të vendimit gjyqësor.

Neni 5 **Heqje dore**

Pala I mund të ushtrojë të drejtën e tij për të hequr dorë nga ushtrimi i shërbimit ndaj palës II. Pala I tërhiqet nga ushtrimi i shërbimit kur pala II ose klienti nuk arrijnë të përbushin detyrimet juridike, morale dhe financiare ndaj palës I në lidhje me shërbimet e tij dhe kur më parë është paralajmëruar nga Pala I që do të tërhiqet në rast se detyrimet nuk përbushen.

Shërbimet ofrohen në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, rrethanave të caktuara faktike, si dhe të informacionit të dhënë nga pala II, Klienti, i cili konsiderohet i vertetë, i saktë dhe i plotë, për atë që Klienti mund të jetë në dijeni. Çdo ndryshim në të dhënat e sipërpermendura, në bazë të të cilave është përbushur Shërbimi përkatës, nuk pasqyron detyrimin e palës I për përbushjen e të njëjtit Shërbim, por, në përputhje me kushtet e reja të krijuara me pas, “perditesimin i konsulences”. Në rast se kërkohet perditesimi i konsulences së dhënë me parë, shërbimi do të ofrohet dhe faturohet në mënyrë të veçantë, me marreveshje paraprake me palën II, Klientin.

Neni 6

Konflikti i Interesave

Pala I, nuk mund të japë shërbim, në rast se ka konflikt interesash të atyre palës II, klientëve midis tyre.

Pala II, Klienti do të njoftohet në mënyrë të plotë për mundësinë e lindjes së një konflikti në të ardhmen apo ekzistencën e një konflikti aktual. Shërbimi lejohet përjashtimisht, vetëm në rast se pala II, klienti jep pëlqimin e tij.

Neni 7

Pronesia Intelektuale

Pala II është titullar i vetëm i çdo të drejte të pronësive intelektuale në lidhje me Shërbimet. Me përfitimin e Shërbimeve, Klienti përfiton të drejtën e përdorimit dhe pronësisë të tyre.

Pala II, Klienti është përfituesi ekskluziv i Shërbimeve. Shërbimet e ofruara nuk mund t'u behen të ditura personave të tretë pa konsensusin, miratimin paraprak të palëve të kësaj kontrate.

Neni 8

Forca Madhore

Nuk do të konsiderohet mospermbushje e detyrimeve nga ana e Palës I, në rast se permbushja e këtyre Shërbimeve bëhet e pamundur si pasojë e ngjarjeve, që janë tej kontrollit të Palës I. Me konstatimin e një rrethane të tillë, Pala I do të njoftojë menjëherë Palën II, Klientin në lidhje me natyrën e rrethanes dhe kohezgjatjen e parashikuar.

Neni 9

Kufizim i Pergjegjesise

Pala I nuk mban përgjegjësi për shperblimin e dëmeve, që mund të vijne si pasojë e ofrimit të Shërbimeve, përveç rasteve kur këto dëme janë shkaktuar me dashjen e tij, saj apo si pasojë e pakujdesisë. Në çdo rast, detyrimi i palës I nuk do të jetë më i madh se sa shumën e tarifës së paguar për permbushjen e Shërbimit.

Neni 10

Marreveshja

Kjo Marreveshje përben marreveshjen e plotë midis Palës I dhe Palës II për ofrimin e Shërbimeve dhe zbatohet me përparësi në lidhje me çdo marreveshje tjetër verbale apo me shkrim. Kjo Marreveshje mund të zgjidhet ose të ndryshohet vetëm me shkrim.

Neni 11

Dokumenti i marrjes në dorëzim të shërbimit

Palët do të nënshkruajnë një certifikate ose procesverbal i cili pasqyron dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit .

Neni 12
Ligji i Zbatueshem dhe Zgjidhja e Konfliktëve

Kjo Marrëveshje interpretohet dhe rregullohet në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë, _____, në bazë të dispozitave të Kodit Shqiptar të Procedurës Civile.

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale.

Pala I (*ofruesi i shërbimit*)

Klienti/ Pala II (*Përfituesi i Shërbimit*)
